



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TE FORMIMIT PROFESIONAL
PUBLIK NR.1 TIRANË**

Nr 231 Prot

Data 23 . 03 . 2022

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

Në zbatim të ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit“, të ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë“, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive“, të udhëzimit nr. 14 datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimatrinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional“,

Ofruesi publik i AFP-së Drejtoria Rajonale e Ofrit të Formimit Profesional Publik nr. 1 Tiranë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për lëvizje paralele për pozicionin instruktor me kohë të pjesshme:

- Mësimdhënës i formimit teoriko-praktik, me kohë të pjesshme i kursit Estetikë--- 1 person

Kritere të përgjithshme

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën,
- c) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale,
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar,
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit,
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Kritere të posaçme

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është


kualifikuar;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a- letërmotivimin për pozicionin;
- b- jetëshkrimin (CV-në);
- c- kartën e identitetit;
- d- diplomën;
- e- librezën e punës;
- f- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k-të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara; Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 01.04.2022


DREJTOR
Hanëme MATA